



Ky projekt bashkëfinancohet nga  
Bashkimi Evropian



# E DREJTA *E SHPËRNDARJES* SË TAKSAVE

—  
NJË MEKANIZËM FINANÇIMI POTENCIAL  
*PËR SHQIPËRINË*

---

Dokument për “Të drejtën e Shpërndarjes së Taksave”.

©2020, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, dhe Asistencës Zyrtare për Zhvillim i Republikës Slovake -Slovak Aid. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian apo të Slovak Aid.

---

# HYRJE

---

Ky dokument është përgatitur në kuadër angazhimit të Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në mbështetje të sektorit të organizatave të shoqërisë civile për zhvillimin e mënyrave alternative të financimit me qëllim rritjen e qendrueshmërisë së tyre.

Partnerët Shqipëri ka përgatitur dokumentin mbi “të drejtën e shpërndarjes së taksave” i cili shërben si një material burimor dhe informues për të gjitha OSHC-të e interesuara për diversifikimin e burimeve financiare.

Ky dokument prezanton konceptin e ri të mekanizmit të shpërndarjes së taksave si një model i qendrueshëm për forcimin e sektorit të OSHC-ve, përmirësimin e imazhit, rritjes së besueshmërisë së publikut dhe qendrueshmërisë financiare.

Në këtë dokument analizohen modelet dhe praktikat më të mira të vendeve të Evropës Juglindore dhe jo vetëm, të cilat kanë qenë pionere të aplikimit të këtij mekanizmi.

Partnerët Shqipëri në vijim të punës së tyre për përmirësimin e klimës së bashkëpunimit midis sektorit publik dhe atij jofitimprurës, synon të kontribuojë në qendrueshmërinë financiare të organizatave të shoqërisë civile duke forcuar kapacitetet e OSHC-ve. Në këtë mënyrë i mundëson atyre eksplorimin e burimeve të reja të të ardhurave si një mënyrë për të siguruar qendrueshmërinë e tyre, pavarësinë nga burimet e zakonshme të financimit nga donatorët dhe institucionet, si dhe për të gjetur metoda të reja për të forcuar impaktin e tyre në komunitetet lokale.

Ky dokument gjithashtu synon të prezantojë një model të ri të financimit të sektorit të OSHC-ve i cili është aplikuar dhe i provuar të jetë i suksesshëm në shumë vende Evropiane si dhe të shtrojë hapat e parë për një debat publik mbi aplikimin e këtij sistemi në Shqipëri.

---

# Përmbajtja

---

03	<b>HYRJA</b>
05	<b>E DREJTA E SHPËRNDARJES SË TAKSAVE</b>
05	Çfarë është “e drejta e shpërndarjes së taksave”
06	Shpërndarësi i taksës “dhuruesi”
07	Përfituesit e skemës së shpërndarjes së taksave
08	Entitetet jofitimprurëse si përfitues primar
09	<b>PROCESI I SHPËRNDARJES SË TAKSAVE</b>
10	Rëndësia financiare e shpërndarjes së taksave
11	Vlera e shtuar
11	<i>a) Fuqizimi i organizatave me bazë komunitare dhe pjesëmarrja e qytetarëve në OJF</i>
11	<i>b) Financimi i decentralizuar, fleksibël dhe më pak burokratik për OJF-të</i>
11	<i>c) Rritja e vizibilitetit, transparencës dhe imazhit publik të OJF-ve</i>
12	<i>d) Nevojat financiare të përmbushura të OJF-ve / zëvendësimi i donatorëve që largohen</i>
12	<i>a) Lejimi taksapaguesve të ndajnë një pjesë të taksave të tyre - d.m.th., buxhetimi me pjesëmarrje</i>
12	<i>b) Mbështetja për qëllime të përfitimit publik</i>
13	Konkluzionet
14	Bibliografi

# E DREJTA E SHPËRNDARJES SË TAKSAVE

## Çfarë është “e drejta e shpërndarjes së taksave”

Koncepti i mekanizmit të të drejtës së shpërndarjes së taksave u shfaq fillimisht në Evropën Qendrore dhe Lindore në debatet e politikave rreth çështjes së financimit të institucioneve të kultit dhe shoqërisë civile në fillim të viteve nëntëdhjetë (1992-1995). Qeveritë e reja të demokratizuara në atë kohë, fillimisht në Hungari e më pas në vendet e tjera po kërkonin mënyra për të vendosur marrëdhënie të reja me këta aktorë shoqërorë.

Pas diskutimeve midis palëve të interesuara, ky mekanizëm u shfaq fillimisht në Hungari dhe më vonë në Sllovaki, Rumani, Lituani dhe Poloni, si një risi e financave publike që kanalizoi fondet publike në shoqërinë civile për qëllime të përfitimit publik në një mënyrë të decentralizuar. Sot, ky mekanizëm shfaqet në forma të ndryshme në secilin prej vendeve që e aplikojnë por parimi thelbësor mbetet sërish i njëjti: dhënia e së drejtës një taksapaguesi të shpërndajë 1-3% të taksave të paguara prej tij mbi të ardhurat, për një organizatë jofitimprurëse, ose në lloje të tjera të entiteteve të përfitimeve publike, si institucionet e kultit (në këtë rast kisha) ose në parti politike.

Arsyet kryesore për prezantimin e këtij mekanizmi ishin: mbështetja dhe zhvillimi i shoqërisë civile, zhvillimi i një kulture dhe tradite filantropike, si dhe de-politizimi i fondeve shtetërore për shoqërinë civile.

Vende të ndryshme kanë prezantuar mekanizma të ndryshëm. Për shembull, në modelin Italian nga ku ka origjinuar ky mekanizëm, “otto per mille”, përfituesit janë kishat. Më vonë, Italia duke vlerësuar qendrueshmërinë këtij mekanizmi përdori të njëjtin model për të futur në rrethin e përfituesve edhe entitete të tjera, siç janë organizatat jofitimprurëse dhe partitë politike.

Sistemi "otto per mille" është një mekanizëm përmes së cilit taksapaguesit italian i jepet e drejta për shpërndarjen e një përqindje të taksës vjetore të të ardhurave personale, ta destinonjë për shërbime sociale në një nga organizatat fetare të vendit (Allen, 2007) (Tremonti, 2015).

Ideja e mekanizmit të së drejtës së shpërndarjes së taksave u shfaq edhe në debatet e politikave edhe përtej Italisë. Në disa vende, mundësia për të zbatuar sistemin vazhdon ende të jetë e debatueshme; ndërsa në vende të tilla si Republika Çeke dhe Estonia, u diskutua dhe u vendos që të mos miratohet një mekanizëm i ngjashëm. Ndërkohë, u diskutua për një formë të një mekanizmi dhe u materializua jo vetëm në Itali, por edhe në Hungari, Japoni, Lituani, Sllovaki, Spanjë, Poloni, Portugali, Rumani, dhe së fundmi në Moldavi. Në Portugali, fillimisht vetëm për qëllime fetare, ndërsa tani një pjesë e taksës mbi të ardhurat mund të shkojë edhe për organizatat jofitimprurëse.

Në Spanjë, taksapaguesit gëzojnë të drejtën që 7% të taksës mbi të ardhurat e tyre t'i kanalizojnë kishave ose t'i shpërndajnë për "qëllime të tjera sociale" (zakonisht këto janë projekte që lidhen me çështje sociale siç janë varfëria, përjashtimi social, të moshuarit, imigracioni, dhe gjithashtu projekte që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës). Por, si në rastin e Portugalisë ashtu dhe në atë të Spanjës, taksapaguesi nuk mund të zgjedhë drejtpërdrejt përfituesin (Montedore, 2011). Në Spanjë, taksapaguesi mund të zgjedhë që në deklaratën e tij të zgjedhë opsionin “kisha” apo “çështje sociale” por jo të nominojë institucionin në mënyrë direkte. Më tej në rastin e kishave, paratë e mbledhura shpërndahen nëpërmjet fondit të mbështetjes së kishave nga shteti, ndërsa paratë e mbledhura nga zgjedhja e opsionit "çështje sociale" përdoren për të financuar projektet sociale të zgjedhura nga ministritë e linjës. Në mënyrë të ngjashme, në Portugali që nga viti 2001, 0.05% mund të shpërndahen, por taksapaguesit nuk mund të nominojnë një entitet përfitues. Shpërndarja e përqindjes së taksave është pjesë e mbështetjes që jep shteti, i cili është burimi më i rëndësishëm financiar për organizatat në Portugali, i ndjekur nga të ardhurat e krijuara nga kontributet e anëtarëve (Franco, 2006).

Këto shembuj të ndryshëm mund të konsiderohen si një interpretim i gjerë i modelit të shpërndarjes së taksave. Vlen gjithashtu të theksohet një variant më interesant i prezantuar në Sllovaki i cili lejon edhe korporatat të shpërndajnë një përqindje të caktuar të taksave të tyre, mekanizëm i cili ka patur ndikim të rëndësishëm pozitiv në qendrueshmërinë financiare të organizatave jofitimprurëse në Sllovaki.

Mekanizmi i të drejtës së shpërndarjes së taksave, si një koncept i kuptuar gjerësisht, është një mekanizëm që kanalizon burimet publike (të mbledhura nga taksat) në një mënyrë të decentralizuar për qëllime të përfitimit publik. Thelbi i mekanizmit të shpërndarjes së taksës i jep të drejtën një taksapaguesi të shpërndajë një pjesë të taksës së tij mbi të ardhurat, për qëllime të përfitimit publik.

---

## Shpërndarësi i taksës “dhuruesi”

Në mekanizmin e të drejtës së shpërndarjes së taksave kemi dy aktorë, individë ose korporata që ushtrojnë të drejtën legjitime për të shpërndarë një përqindje të caktuar të taksave të tyre, si dhe të përcaktojnë entitetin përfitues.

Delegimi i fuqisë vendimmarrëse një taksapaguesi, për të shpërndarë një pjesë të taksave të tij/saj, është një karakteristikë e këtij mekanizmi. Një zgjidhje e tillë është e pashembullt në rajonin postkomunist dhe mund të konsiderohet si një formë unike e një buxheti me pjesëmarrje dhe jo filantropi. Në përgjithësi, taksapaguesit individë mund ta shfrytëzojnë këtë mundësi, ndërsa në Sllovaki përshembull, korporatat gjithashtu kanë mundësinë të shërndajnë një përqindje të caktuar të taksave të tyre.

Në mekanizmin e shpërndarjes së taksave, taksapaguesit individë marrin vendimet e tyre në mënyrë autonome (pa asnjë ndikim politik ose ekonomik) që respektohen dhe nuk kundërshtohen nga ndonjë entitet, për arsye të tjera përveçse formale në rastet kur vërehen parregullsi.

Individi synon të mbështesë të mirën publike, të lehtësojë dhimbjet e problemeve sociale dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për njerëzit, siç bën edhe në rastin e filantropisë dhe bamirësisë. Megjithatë, ekziston një dallim i madh midis mekanizmit të shpërndarjes së taksave dhe filantropisë. Në rastin e filantropisë, përdoren burimet private të individëve ndërsa në rastin e mekanizmit të shpërndarjes së taksave, burimet e shpërndara kanë të bëjnë me të ardhurat personale, por ato janë taksa që individë i paguan gjithsesi.

Kjo është arsyeja pse ky mekanizëm nuk duhet të konsiderohet filantropi dhe burimet e shpërndara nuk janë dhurime. Kjo gjithashtu do të thotë që opsioni i shpërndarjes së taksave është në dispozicion vetëm për taksapaguesit, ndryshe nga filantropia, që është e hapur për këdo.

## Përfituesit e skemës së shpërndarjes së taksave

Sistemi i shpërndarjes së taksave shpesh shihet si një mekanizëm mbështetës financiar për sektorin jofitimprurës/organizatat e shoqërisë civile.

Së pari, në disa vende, në mekanizmin e të drejtës së shpërndarjes së taksave, grupet përfituese mund të jenë kisha, parti politike si dhe shoqëria civile (Figura 1).




Figura 1: Grupet e përfituesve të skemës së shpërndarjes së taksave

Për shembull, në Itali ekzistojnë tre mekanizma të së drejtës së shpërndarjes së taksave që synojnë përfitues të ndryshëm: a) një mekanizëm ku kontributi shkon për kishat, b) një për partitë politike dhe c) një tjetër për entitetet jofitimprurëse. Në pesë vendet e Europës JugLindore, ky mekanizëm funksionon në mbështetje të maksimumi 2 lloje entitetesh a) për organizatat jofitimprurëse dhe b) kishat (rasti i Hungarisë), ose a) për organizatat jofitimprurëse dhe b) për partitë politike (rasti i Lituanisë). Në Poloni, Sllovaki dhe Rumani, ekziston "vetëm" një mekanizëm për entitetet jofitimprurëse dhe entitetet e tjera të përfitimeve publike.

Kjo do të thotë që nga mekanizmi i të drejtës së shpërndarjes së taksave, mund të përfitojnë edhe subjektet jofitimprurës si kishat dhe partitë politike, pa qenë domosdoshmërisht organizata të shoqërisë civile, siç është rasti në shumicën e vendeve.

Së dyti, duhet të theksohet se në mekanizmin e përcaktimit të përqindjes, grupi kryesor përfitues janë organizatat jofitimprurëse të shoqërisë civile dhe më pas llojet e tjera të personave juridikë (nga sektori publik ose privat) të cilët shpesh përfshihen në të njëjtin grup si subjektet e pranueshëm për shpërndarjen e përqindjes së dhënë.

Ndërsa mekanizmi shpesh perceptohet të sjellë përfitime vetëm për organizatat jofitimprurëse "grass-root", në disa vende, kishat, entitetet publike, sindikatat, dhe madje edhe individët në nevojë mund të jenë përfitues të këtij sistemi.

Është e gabuar të supozohet se përfituesit e mekanizmit të shpërndarjes së taksave janë vetëm organizata jofitimprurëse. Ekzistojnë të paktën tre kategori të gjera të cilat përfitojnë prej mekanizmit të shpërndarjes së taksave në vendet që kanë adoptuar këtë sistem. Andaj, është e gabuar të mendohet se nga sistemi i shpërndarjes së taksave përfiton vetëm sektori i shoqërisë civile nëpërmjet organizatave jofitimprurëse.

Figura 2: Mekanizmat e shpërndarjes së taksave sipas shteteve



---

## Entitetet jofitimprurëse si përfitues primar

Synimi për të mbështetur organizatat jofitimprurëse si subjekte me qëllime të përfitimit publik është i dukshëm në të gjitha vendet evropiane të cilat kanë adoptuar këtë mekanizëm. Në Poloni, përfituesit e këtij mekanizmi përfshijnë vetëm ato OJF të cilat kanë marrë statusin e përfitimit publik, ndërkohë në Lituani përfituesit e ligjit fillimisht ishin subjekte që kishin të drejtën për të marrë dhurime bamirësie. Në Rumani përfituesit fillestar të këtij ligji ishin subjekte jofitimprurëse. Ndërsa në Sllovaki, ligji në përkufizimin e tij parashikon në mënyrë të qartë një listë të përfituesve të mundshëm që ndërthurin OJF-të "grassroot" me lloje të tjera të OJF-ve me karakteristika të ndryshme të veçanta, të tilla si organizata me bazë fetare dhe ndërkombëtare.



# PROCESI I SHPËRNDARJES SË TAKSAVE

Hapat kryesorë të cilat përshkohen në procesin e mekanizmit të shpërndarjes së taksave janë të njejta në secilin nga vendet e EQL-së.

Në një analizë të thjeshtë të realizuar, vihet re se procedura thelbësore e mekanizmit është e njejtë ndër vite në të gjitha vendet aplikuese të mekanizmit. Në këtë mekanizëm taskapaguesi individ, komunikon vendimin e tij për shpërndarjen e përqindjes së taksave mbi të ardhurat personale autoriteteve tatimore, dhe entitetit përfitues i akordohet shuma e përcaktuar nga individ. Më tej, teknikalitete të vogla të mekanizmit dhe rregullimet në procese dhe procedura ndryshojnë nga një vend në tjetrin (Török & Moss, 2004).

## **Hapi 1**

Në fund të vitit tatimor, taksapaguesi paguan detyrimet e plota tek autoriteti tatimor. Nëse individ dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij, mund të vendosë të caktojë të shpërndajë një përqindje të caktuar të taksave të tij për një qëllim publik. Vendimi në lidhje me shpërndarjen e taksave është plotësisht vendimi i taksapaguesit i cili emëron një entitet konkret si përfitues. Psh, nëse një person paguan 100 Lek në tatimin mbi të ardhurat personale, në fund të vitit, ai person mund të vendosë që të shpërndajë një përqindje të caktuar të atyre taksave, të themi 2%, d.m.th 2 Lek, një entiteti që i shërben të mirës publike sipas zgjedhjes së tij (brenda kufijve të rregulloreve). Në disa vende, përdoret një sistem i hapur, aktiv ku organizatat janë të renditura paraprakisht dhe taksapaguesit mund të zgjedhin vetëm nga ajo listë (Italia, Polonia dhe Sllovakia dhe duke filluar nga viti 2015 edhe Hungaria) ndërsa në vendet e tjera nuk ka asnjë listë të dhënë paraprake.

## **Hapi 2**

Nëse taksapaguesi vendos të ushtrojë këtë të drejtë, ai komunikon vendimin e tij tek autoriteti tatimor i cili do të pasojë duke transferuar shumën 2 Lek (në shembullin tonë) tek njësi ekonomike. Nëse taksapaguesit vendosin të mos e shfrytëzojnë këtë mundësi, taksat mbi të ardhurat personale paguhen plotësisht dhe përdoren si zakonisht nga shteti. Në disa prej vendeve (në Lituani, Sllovakia, Poloni dhe Rumania), ekziston një mundësi e ndarjes së shpërndarjes së taksave midis disa përfituesve pra jo vetëm një përfitues.

## **Hapi 3**

Entiteti përfitues duhet të marrë dhe të përdorë burimet e krijuara nga shpërndarja e taksave sipas ligjit. Në modelin klasik të mekanizmit, për shkak të arsyeve të mbrojtjes së të dhënave, entiteti përfiton burimet pa e ditur se kush ka kontribuar për këto burime. Kohët e fundit (2015), Sllovakia dhe Hungaria miratuan një sistem që lejon përfituesit të njihen me identitetin e “dhuruesit” të tyre por gjithmonë nëse taksapaguesi autorizon autoritetin tatimor të zbulojë identitetin e tij, por jo shumën e alokuar. Në disa vende, cikli përfundon me përfituesit që raportojnë për përdorimin e shumave të shpërndara.


Në rast se do të jepnim një përkufizim për mekanizmin e shpërndarjes së taksave, do të ishte: “një mekanizëm i decentralizuar i vendimmarrjes, ku përqindje të shpërndara të taksave mbi të ardhurat kanalizohen kryesisht tek organizata jofitimprurëse si dhe entitete të tjera me qëllime të përfitimit publik”.

## Rëndësia financiare e shpërndarjes së taksave

Supozohet nga shumë njerëz dhe është e pamohueshme se sistemi i mekanizmit shpërndarjes së taksave siguron një kontribut të konsiderueshëm financiar për të ardhurat e sektorëve jofitimprurës, madje disa besojnë se ai është një nga burimet më të rëndësishme të financimit në vendet ku është aplikuar ky sistem.

Për të vlerësuar nëse e drejta e shpërndarjes së taksave është një mekanizëm kryesor mbështetës financiar për sektorin jofitimprurës, duhet kuptuar vlera proporcionale që zënë të ardhurat nga sistemi i shpërndarjes së taksave në raport me të ardhurat e përgjithshme të sektorit jofitimprurës. Në një studim të kryer në vendet e EQL-së të cilat kanë adoptuar mekanizmin e shpërndarjes së taksave, të ardhurat nga mekanizmi i shpërndarjes së taksave, në raport me të ardhurat e përgjithshme të sektorit jofitimprurës në pesë vendet e EQL-së janë rreth 2%. Prandaj supozimi se mekanizmi i shpërndarjes së taksave është një nga burimet më të rëndësishme të financimit për sektorët jofitimprurës është i gabuar.

Figura 3: Raporti i të ardhurave nga mekanizmi i shpërndarjes së taksave me totalin e të ardhurave



Ndërsa mekanizmi i shpërndarjes së taksave zë një pjesë të vogël të të ardhurave të përgjithshme të sektorit jofitimprurës në vendet e EQL, disa besojnë se është burimi më i rëndësishëm për tre arsye:

a) është burimi më i rëndësishëm për shumë entitete

Ekziston një numër organizatash për të cilët të ardhurat që përfitojnë nga mekanizmi i shpërndarjes së taksave janë i vetmi burim i të ardhurave për organizatën e tyre. Vlen të përmendet ky fakt pasi këto organizata që përfitojnë nuk janë të pakta në numër.

b) përdoret shumë nga përfituesit e mundshëm në shumë vende, dhe

Në të gjitha vendet e EQL ku është i aplikuar mekanizmi i së drejtës për shpërndarjen e taksave është konstatuar se përfituesit kryesorë janë organizatat e vogla që kanë vërtet nevojë dhe që punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me komunitetin.

c) ka një komponent të fortë komunikimi që arrin te publiku.

Duke qenë se për shumicën e vendeve që aplikojnë këtë mekanizëm, të ardhurat që sigurohen nga shpërndarja e taksave janë burimi i vetëm për organizatat jofitimprurëse nga shteti, ky mekanizëm siguron efektshmëri të lartë në komunikimin e organizatave me sektorin publik.

## Vlera e shtuar

Besohet se përveç sigurimit të mbështetjes monetare për qëllime të përfitimit publik, sistemi ka pasur efekte anësore të shumta, disa prej të cilave kanë impakt të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e organizatave me qëllim përfitimin publik, veçanërisht për sektorin e OJF-ve.

Dimensionet e vlerës së shtuar të mekanizmit të shpërndarjes së taksave mund të grupohen në dy grupe kryesore: a) në lidhje me shoqërinë civile dhe b) në lidhje me taksapaguesit.

### Në lidhje me *shoqërinë civile*:

#### **a. Fuqizimi i organizatave me bazë komunitare dhe pjesëmarrja e qytetarëve në OJF**

Ideja që qëndron pas këtij qëllimi ishte të përdorej mekanizmi i shpërndarjes së taksave si një mjet për të intensifikuar lidhjen midis publikut dhe organizatave të shoqërisë civile.

Menjëherë pas viteve 90', e cila konsiderohet si periudha e "artë" e shoqërisë civile në Evropën post-komuniste, u duk qartë që shoqëria civile nuk do të luante një rol aq të rëndësishëm siç pritej. Zhgënjimi me transformimin pas komunizmit dhe reformat politike dhe institucionale të shoqëruara me trashëgiminë e mosbesimit ndaj organizatave dhe kapitalit të fortë social, konsiderohen elementët kryesorë që kontribuan në dobësinë e dokumentuar të shoqërisë civile në Evropën post-komuniste (Howard, 2011). Kjo dobësi është pranuar nga shumë akademikë megjithëse disa sugjerojnë që kjo pikëpamje kërkon debat, dhe se hapësira e shoqërisë civile pas komunizmit është mjaft e larmishme (Ekiert, 2011). Dobësia zakonisht shfaqet në nivelet e ulëta të pjesëmarrjes dhe vullnetarizmit, si dhe në anëtarësimin në organizatat e shoqërisë civile (Howard, 2011)

#### **b. Financimi i decentralizuar, fleksibël dhe më pak burokratik për OJF-të.**

Ky aspekt duket se është më shumë një realizim post-hoc i efektit të shpërndarjes së taksave, sesa një qëllim politikash në momentin e adoptimit të mekanizmit.

- *Financim i decentralizuar*

Të dhënat nga vendet e që kanë implementuar mekanizmin e shpërndarjes së taksave sugjerojnë se intensiteti i ndikimit të shtetit në shpërndarjen e fondeve për shoqërinë civile ka ndryshuar me kalimin e kohës. Herë më i fortë dhe ndonjëherë më i dobët në ndikimin e këtyre alokimeve. Mekanizmi i shpërndarjes së taksave ka decentralizuar sigurimin e një pjese të financimeve qeveritare për shoqërinë civile, dhe në vend të burokracisë së centralizuar, janë taksapaguesit ata që marrin vendime. Kjo ka bllokuar në mënyrë efikase mundësinë e shtetit të ndikojë në atë zgjedhje.

- *Procese jo-burokratike dhe fleksibël*

Të dhënat tregojnë se sistemi është mjaft fleksibël nga perspektiva e përfituesve. Nuk ka shumë kushte që i bashkëlidhen mekanizmit të përfitimit, siç është rasti me mekanizmat e tjerë subvencionues publik. Në kontekstin e kërkesave administrative në rritje, të bashkangjitura në skema të ndryshme të subvencioneve dhe granteve, vlera e fleksibilitetit të fondeve qëndron, veçanërisht për OJF-të "grassroot", për të cilat aksesit në fonde burokratike dhe administrative është mjaft i kufizuar.

- *Burime stabël, në kohë dhe të parashikueshme*

Sistemi sot siguron fonde të sakta dhe në kohë për përfituesit e tij. Afati kohor i transferimit të fondeve për përfituesit ndryshon nga 2-3 muaj (Sllovakia) deri në 6-10 muaj (Rumani). Ekziston edhe një përfitim i shtuar i parashikueshmërisë. Fondet arrijnë në një periudhë të parashikueshme çdo vit dhe kjo është një vlerë e shtuar e rëndësishme për planifikimin financiar dhe përpjekjet e qëndrueshmërisë së përfituesve. Gjithashtu aftësitë e planifikimit financiar të organizatave mund të jenë përmirësuar për shkak të parashikueshmërisë në kohë të burimeve që vijnë nga mekanizmi i shpërndarjes së taksave.

#### **c. Rritja e vizibilitetit, transparencës dhe imazhit publik të OJF-ve**

Në këtë fushë, ndikimi midis organizatave përfituese është i pabarabartë. Për shkak të natyrës së tij të thjeshtë dhe të pa njohur, mekanizmi përdoret më shumë nga përfituesit grassroot dhe jo vetëm nga organizatat e mëdha. Në të njëjtën kohë, mekanizmi lehtëson komunikimin intensiv të OJF-ve në sferën publike, në këtë mënyrë duke rritur besueshmërinë dhe përmirësuar imzhin e OJF-ve.

**d. Nevojat financiare të përmbushura të OJF-ve / zëvendësimi i donatorëve që largohen.**

Në shumicën e vendeve të rajonit, mekanizmi i shpërndarjes së taksave u prezantua në fillim të viteve 2000, që ishte një periudhë e konsolidimit demokratik dhe shfaqjes së stabilitetit ekonomik që bëri që shumë donatorë të jashtëm publik dhe privatë të tërhiqeshin nga mbështetja e ndërtimit të shoqërisë civile dhe të kalonin në zona të tjera të cilat kishte nevojë. Kështu që qëllimi në atë kohë ishte pjesërisht për të përmbushur kërkesat financiare të OJF-ve në kontekstin e zvogëlimit të fondeve dhe në kontekstin e filantropisë vendase ende të pazhvilluar.

**e. Promovimi i solidaritetit dhe filantropisë**

Në këtë racionalizim të politikës, pritshmëria për mekanizmin e shpërndarjes së taksave ishte që të lejojë taksapaguesit të tregonin solidaritet (pa asnjë kosto për ta) dhe të vepronin si një shkollë e filantropisë, për të kontribuar në ndërtimin e një kulture filantropike që ishte e pazhvilluar. Bazuar në të dhënat e disponueshme, ky ka qenë një qëllim marginal dhe ndoshta një racionalizim post-hoc, sesa një qëllim politik i guximshëm.

Argumenti për këtë arsytim politik është i qartë. Dyzet vjet përvojë në shtetet e mirëqenies totalitare gjatë komunizmit shkatërruan strukturën shoqërore që ishte ndërtuar me shekuj. Shteti paternalist edukoi disa breza me idenë se iniciativa ndëshkohet dhe se pritja pasive do të shpërblehet. Në të njëjtën kohë, individualizmi u shfaq si një virtyt i kapitalizmit dhe shqetësimi për të mirën e përbashkët u shty përsëri. Në këtë kontekst, është një politikë e shëndoshë për të ringjallur dhe ushqyer solidaritetin shoqëror.

Të dhënat nuk janë të përshtatshme për të bërë një lidhje midis nivelit të dhurimit dhe vlerës së shpërndarë nga taksat. Sidoqoftë, ka prova, se filantropia private në disa vende të rajonit po rritet ndjeshëm.

**Në lidhje me taksapaguesit:**

**a. Lejimi taksapaguesve të ndajnë një pjesë të taksave të tyre - d.m.th., buxhetimi me pjesëmarrje.**

Opsioni që u është dhënë taksapaguesve që të vendosin lirshëm për shpërndarjen e taksës është shfaqur në debatin e politikave në Hungari dhe që prej asaj kohe, është diskutuar vazhdimisht në vendet e tjera. Ky lloj mekanizmi decentralizon vendimmarrjen nga pushteti qendror në dorën e taksapaguesve të cilët në mënyrë autonome vendosin për shpërndarjen e taksave të tyre. Ky si proces ka shënjuar një hap të madh përpara në kontekstin e buxhetimit me pjesëmarrje ku roli individit sa vjen e forcohet me shumë.

**b. Mbështetja për qëllime të përfitimit publik**

Mbështetja për qëllime të përfitimit publik - fetar, kulturor, shoqëror dhe të tjerë - ka qenë qëllimi dhe ndikimi kryesor i mekanizmit. Për shembull, në Sllovaki, versioni i hershëm i sistemit u përqëndrua vetëm në qëllimet e përfitimit publik (Woleková 2000). Sipas kësaj logjike, është më e rëndësishme që të përmbushet qëllimi i përfitimit publik sesa kush vepron në të - një organizatë e shoqërisë civile ose një institucion publik. Ndërkohë në programin qeveritar të Hungarisë në vitin 1994, u përcaktua se fushat që kanë të drejtë të përfitojnë nga mekanizmi i shpërndarjes së taksave nuk do të jenë me karakter politik, qëllim biznesi ose advokimi. Kjo qasje është e ndryshme në Lituanë, ku mekanizmi i shpërndarjes së taksave është përdorur edhe për financimin e partive politike.

## Konkluzionet

---

- Punimi ka për qëllim të ofrojë një mekanizëm të ri mbështetjeje për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri. Mekanizmi i të drejtës për shpërndarjen e taksave është një mundësi për të zgjidhur nevojat financiare të sektorit jofitimprurës, si dhe gjithashtu të ndihmojë zhvillimin e organizatave jofitimprurëse.
- Ky punim kërkon të japë përgjigje 2 pyetjeve kryesore si: çfarë është mekanizmi i të drejtës së shpërndarjes së taksave dhe cili është roli i këtij mekanizmi në financimin e sektorit jofitimprurës.
- Bazuar në modelet e prezantuara si dhe ndikimin financiar e social të tyre, mund të arrihet në përfundimin se prezantimi i mekanizmit të shpërndarjes së taksave në Shqipëri, do të ishte i dobishëm për organizatat jofitimprurëse si një mënyrë që do të krijonte një burim të mëtejshëm të financimit të tyre nga administrata shtetërore. Edhe pse kjo situatë nuk ka gjasa të ndodhë në të ardhmen e afërt pasi do të përfaqësonte shpenzime shtesë në buxhetin e shtetit dhe kërkon një vlerësim më të thellë të gjithë impaktit që do të sjellë, është me vlerë të prezantohet si një model efektiv cili mund të aplikohet në të ardhmen edhe në Shqipëri.
- Është e pamohueshme që nga njëra anë, mekanizmi i shpërndarjes së taksave sjell një sërë efektesh pozitive, siç është decentralizimi i vendimmarrjes së qytetarëve për taksat e tyre apo mbështetja e qëllimeve me përfitim publik. Më tej, në lidhje me organizatat, ofrohet një financim i decentralizuar dhe shumë fleksibël; gjithashtu vendosja e kontakteve më të ngushta ndërmjet organizatave jofitimprurëse dhe taksapaguesve që ushtrojnë të drejtën për shpërndarjen e taksave mund të shihet si një avantazh, i cili sigurisht ndikon pozitivisht në vizibilitetin e organizatave jofitimprurëse.
- Nga ana tjetër, mekanizmi i shpërndarjes së taksave sjell gjithashtu një sërë pasojash negative që duhen marrë parasysh. Ndër to mund të përmendim: rritjen e kostove administrative që lidhen me administrimin e mekanizmit të shpërndarjes së taksave, si dhe komplikimet e tjera të sistemit tatimor. Nëse do të prezantohet ky mekanizëm, është e nevojshme të përcaktohet qartë se cila është dobia e tij publike si dhe gjithashtu të sigurohet një kontroll i mjaftueshëm për të parandaluar abuzimet që mund të ndodhin me mekanizmin e shpërndarjes së taksave.

---

## Bibliografi

---

Allen, J. L. (2007). *All the Pope's Men*. Crown Publishing Group.

Ekiert, G. a. (2011). "Civil Society Weakness in Post-Communist Europe: A Preliminary Assessment." *Carlo Alberto Notebooks (Collegio Carlo Alberto)*, no. 198 .

Franco, R. C. (2006). *The Portugese Nonprofit Sector in Comparative Perspective*. Universidade Católica Portuguesa Porto, Johns Hopkins University.

Howard, M. M. (2011). "Civil Society in Post-Communist Europe." In *The Oxford Handbook of Civil Society*, edited by Michael Edwards, 134-145. New York: Oxford University Press.

Montedore, C. a. (2011). *Come Strumento Di Partecipazione Nel Nuovo Modello Di Welfare*. Ministero Del Lavoro E Delle Politiche Sociali, Rome: ISFOL,.

Török & Moss, T. M. (2004). "Percentage Philanthropy." Retrieved from <http://szazalekosadomany>.

Tremonti, G. (2015). "L'otto per mille trent'anni dopo. Intervento all'incontro dell'Associazione Amici dei.

---

# Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga e Elbasanit, N. Park Gate, H. 3 Ap. 71/73, Kutia  
Postare 2418/1, 1022, Tiranë, Shqipëri

---

[www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)